

BILANCI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Tremujori II – 2026

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026, energjia në dispozicion u rrit me 5,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.


Prodhimi neto vendas i energjisë elektrike, në këtë periudhë, u rrit me 34,4 %, duke arritur në 2.361 GWh, nga 1.757 GWh në tremujorin e dytë të vitit 2025.

Ky prodhim u realizua në masën 42,8 % nga hidrocentralet publike, 38,2 % nga hidrocentralet private dhe koncesionare dhe 19,0 % nga prodhuesit e tjerë.

Importi bruto i energjisë elektrike, përfshirë shkëmbimet (energji në marrje), në tremujorin e dytë të vitit 2026, arriti në 569 GWh, nga 725 GWh në të njëjtën periudhë të vitit 2025, duke shënuar një ulje prej 21,5 %.

Eksporti bruto i energjisë elektrike, përfshirë shkëmbimet (energji në dhënie), në tremujorin e dytë të vitit 2026, arriti në 991 GWh, nga 638 GWh në të njëjtën periudhë të vitit 2025, duke shënuar një rritje prej 55,4 % (fig. 1).

FIG. 1 ENERGJI NË DISPOZICION, PRODHIMI NETO VENDAS, IMPORTI DHE EKSPORTI BRUTO



TAB. 1 BILANCI I ENERGJISË ELEKTRIKE

		(MWh)	
Treguesit		Tr II 2025	Tr II 2026
A	Energji në dispozicion (A=1+2-3)	1.844.114	1.939.051
1	Prodhimi neto vendas (1=1.1+1.2+1.3)	1.756.531	2.361.155
1.1	Termocentrale	0	0
1.2	Hidrocentrale (1.2=a+b)	1.468.498	1.913.054
a	Publike (a=a.1-a.2)	703.959	1.010.549
a.1	Prodhim bruto i hidrocentraleve publike	710.383	1.018.448
a.2	Humbje dhe konsum vetjak	6.424	7.899
b	Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë	764.538	902.505
1.3	Të tjerë prodhues (energji të rinovueshme të tjera)	288.034	448.102
2	Importi bruto (energji në marrje)	725.289	569.163
3	Eksporti bruto (energji në dhënie)	637.706	991.268
B	Konsumi i energjisë elektrike (B=1+2)	1.844.114	1.939.051
1	Humbjet në rrjet (1.1+1.2)	319.592	320.041
1.1	Humbjet dhe konsumi vetjak në transmetim	43.740	52.654
1.2	Humbjet në shpërndarje (1.2=a+b) ¹	275.852	267.387
a	Humbjet teknike në shpërndarje	202.398	146.675
b	Humbjet jo teknike në shpërndarje ²	73.454	120.711
2	Përdorimi nga konsumatorët (2=2.1+2.2)	1.524.522	1.619.010
2.1	Familjarë	779.792	823.081
2.2	Jo Familjarë	744.731	795.929

¹ Detajimi i humbjeve teknike dhe jo teknike bazohet në vlerësimet e kryera nga operatorët që operojnë në fushën e energjisë elektrike

² Humbjet jo teknike përfshijnë edhe diferencat statistikore që rrjedhin nga mosdeklarimet e prodhimit dhe nga mospërputhjet në kohën e matjes së prodhimit me të dhënat e shitjes apo konsumit.


Hidrocentralet publike, në tremujorin e dytë të vitit 2026, prodhuan 1.011 GWh, nga 704 GWh në të njëjtën periudhë të vitit 2025, duke shënuar një rritje të prodhimit me 43,6 %.

Hidrocentralet private dhe koncesionare prodhuan 903 GWh, nga 765 GWh në të njëjtën periudhë të vitit 2025, duke shënuar një rritje të prodhimit me 18,0 %.

Prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit e tjerë arriti në 448 GWh, nga 288 GWh në të njëjtën periudhë të vitit 2025, duke shënuar një rritje prej 55,6 %.

Shkëmbimi i energjisë elektrike (diferenca ndërmjet eksportit dhe importit bruto të energjisë), në tremujorin e dytë të vitit 2026, rezultoi pozitiv në nivelin 422 GWh, duke reflektuar një nivel më të lartë të eksporteve krahasuar me importet (fig. 2).

FIG. 2 SHKËMBIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE




Humbjet në rrjet u rritën lehtë, me 0,1 %, duke arritur në 320,0 GWh në tremujorin e dytë të vitit 2026, nga 319,6 GWh në të njëjtën periudhë të vitit 2025.

Pesha e **humbjeve në rrjet** ndaj energjisë elektrike në dispozicion, gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026, ishte 16,5 %, kundrejt 17,3 % në të njëjtën periudhë të vitit 2025, duke shënuar një ulje prej 0,8 pikë përqindjeje.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2026, **humbjet në transmetim** u rritën me 20,4 %, ndërsa humbjet në shpërndarje u ulën me 3,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 (fig. 3).


FIG. 3 KONSUMI I ENERGJISË ELEKTRIKE, HUMBJET NË RRJET DHE PËRDORIMI NGA KONSUMATORËT



Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët, në tremujorin e dytë të vitit 2026, u rrit me 6,2 %, duke arritur në 1.619 GWh, nga 1.525 GWh në tremujorin e dytë të vitit 2025.

Në rritjen e përdorimit të energjisë elektrike nga konsumatorët ndikuan si **konsumatorët familjarë**, konsumi i të cilëve u rrit me 5,6 %, ashtu edhe **konsumatorët jo familjarë**, të cilët shënuan një rritje të konsumit me 6,9 %, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2025 (fig. 4).

FIG. 4 PËRDORIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KONSUMATORËT



Shënim për përdoruesit:

- Të dhënat e detajuara janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Energjia](#)
- Në zbatim të Politikës së Trajtimit të Gabimeve, INSTAT ndërmerr pa vonesë korrigjimin e çdo gabimi të identifikuar në statistikat zyrtare të publikuara. Përdoruesit informohen në mënyrë të menjëhershme dhe transparente për korrigjimet dhe ndryshimet e reflektuara, në përputhje me parimet e paanshmërisë, transparencës dhe cilësisë së statistikave zyrtare. Politika e plotë e Trajtimit të Gabimeve është e disponueshme në adresën: <https://www.instat.gov.al/media/9577/politika-e-trajtimit-te-gabimeve.pdf>

Metodologjia

Bilanci i energjisë elektrike jep informacion statistikor mbi prodhimin neto vendas të energjisë elektrike, shkëmbimin e energjisë elektrike, humbjet në rrjet, si dhe konsumin final në vend.

Statistikat për energjinë elektrike publikohen për periudha tremujore, bazuar në të dhëna mujore të grumbulluara nga burime administrative si:

- KESH sh.a., shoqëri shtetërore që prodhon, transformon dhe kryen shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike;
- OSSH sh.a., shoqëri shtetërore që kryen shpërndarjen e energjisë elektrike, si edhe ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes;
- OST sh.a., shoqëri shtetërore që operon sistemin e transmetimit të energjisë elektrike. OST sh.a. garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:
 - furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes dhe konsumatorëve të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit;
 - transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet vendase;
 - tranzitin dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit.

Përkufizimet e treguesve bazë

Energjia në dispozicion i referohet sasisë së energjisë elektrike të prodhuar në vend, së cilës i shtohet sasia e importuar (përfshirë shkëmbimet) dhe i zbritet sasia e eksportuar (përfshirë shkëmbimet).

Prodhimi neto vendas llogaritet si shuma e prodhimit bruto të energjisë elektrike nga të gjithë prodhuesit në vend (hidrocentrale, termocentrale dhe prodhues të tjerë), duke zbritur konsumin dhe humbjet vetjake në prodhim.

Energjia termo i referohet energjisë elektrike të prodhuar nga termocentralet.

Energjia hidro i referohet energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentralet.

Humbjet dhe konsumi vetjak i referohen energjisë elektrike të përdorur nga veprimtaritë ndihmëse të stacioneve të prodhimit, si ftohja e ujit, shërbimet e brendshme, ndriçimi, etj.

Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë i referohen prodhuesve privatë të energjisë elektrike, të cilët në Shqipëri përfshijnë impiante të privatizuara ose të ndërtuara nga subjekte private vendase apo të huaja përmes kontratave koncesionare. Këta prodhues lidhen direkt në sistemin e transmetimit, licencohen nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe mund të shesin energji OST-së, OSSH-së apo klientëve të tjerë.

Prodhues të tjerë i referohet prodhimit të energjisë elektrike nga burime të tjera, duke përfshirë energjinë hidro dhe termo (p.sh. fotovoltaike).

Shkëmbimi i energjisë elektrike i referohet diferencës midis eksportit dhe importit të energjisë elektrike, duke përfshirë edhe tranzitet dhe shkëmbimet me vendet e rajonit.

Konsumi i energjisë elektrike i referohet përdorimit të energjisë nga konsumatorët familjarë dhe jo familjarë, si edhe humbjeve në rrjet.

Humbjet në rrjet përfshijnë humbjet në transmetim (duke përfshirë edhe konsumin vetjak në transmetim) dhe humbjet në shpërndarje. Humbjet teknike në shpërndarje vlerësohen nga OSSH sh.a., ndërsa humbjet jo teknike përfaqësojnë diferencën midis humbjeve totale në shpërndarje dhe humbjeve teknike, si edhe diferencat statistikore që rrjedhin nga mos përputhjet në kohën e matjes së prodhimit dhe konsumit.

Përdorimi nga konsumatorët është i barabartë me shumën e energjisë elektrike të konsumuar nga konsumatorët familjarë dhe jo familjarë.

Konsumatorët familjarë i referohen konsumit të energjisë elektrike në familje.

Konsumatorët jo familjarë i referohen konsumit të energjisë elektrike nga sektorët e industrisë, transportit, bujqësisë, shërbimeve publike, etj, duke përjashtuar familjarët.